

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shkarkohet Ilir Topi/ Ish-drejtuësja e CFO Pharma pritet të drejtojë Fondin e Sigurimeve
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/24/shkarkohet-ilir-topi-ish-drejtuësja-e-cfo-pharma-rexhina-bici-pritet-te-drejtoje-fondin-e-sigurimeve/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 08:00:47 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 07:56:32 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a89782cf29055347fd454d7a7fc159e45e808d4d37a7c42ed1377a77781564e2
TEKSTI	21c0c0f2aa9d7eb463b4b95e833e95e7602314784e0d88deee1c5c54e42cbfffb
PAMJA	57fa0b57940c9b570b3b0e48769019031db0b9ee67029c2d60ad4303c0147be3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e4e84dbc7c4569046d4184c0f679c2e680d0c1db7e25dd30a6e40dbbdb33081c
E MËPARSHMJA	077a9c8f838efcec1ed44591cd941f46cb8786d78b1de4a31f69cb99f2e2c239
RRËNJA MERKLE	ff908387fa0a76615844b1eb2f3b6d25afb991cdfafb8197b5cbb8a7a203d8c9
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e4e84dbc7c4569046d4184c0f679c2e680d0c1db7e25dd30a6e40dbbdb33081c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

Shkarkohet Ilir Topi/ Ish-drejtuësja e CFO Pharma pritët të drejtojë Fondin e Sigurimeve

09:56 : 24/09/2026 në AKTUALITET, INVESTIGIME, KRONIKE, KRYESORE

Nga **Boldnews.al**

Shkarkohet nga detyra Ilir Topi, drejtori i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSKDSH). **"Boldnews.al"** mëson se vendimi është marrë këtë të Mërkurë (23 shtator 2026) nga Ministria e re e Shëndetësisë, Klodiana Spahiu.

Në krye të institucionit pritët të emërohet Rexhina Bici, e cila aktualisht mban pozicionin e zv.drejtuës së Operatorit të Shërbimeve të Integruara Shëndetësore (OSHISH).



Në foto: Ilir Topi, drejtori i deritanishëm i Fondit të Kujdesit Shëndetësor

Rexhina Bici nuk është aspak e panjohur për stafin e Fondit të Kujdesit Shëndetësor. Disa

TË GJITHA



Alabbari rrëmben Maldivet/ Kompleks turistik 20 miliardë usd, por shteti përfiton shumë më tepër se në Shqipëri

14:29 : 24/09/2026



Aksident në Krujë, makina përfundon në kanal, dy të plagosur

14:22 : 24/09/2026



Zjarr i madh në Krujë

14:14 : 24/09/2026



Berisha: SHISH ka përgjuar gazetarë, Vlora Hyseni mund të shantazhojë edhe prokurorë e gjyqtarë

14:00 : 24/09/2026



Evropa, plane emergjente pas provokimeve ruse/ Skenarët

13:54 : 24/09/2026



Përplasjet me policinë në protestë, 17 qytetarë janë shoqëruar në komisarate

13:39 : 24/09/2026



Deklarata e ish-kreut të SHISH drejtuar gazetares, reagon AGSH: Shantazh, të ndërhyjë SPAK!

13:37 : 24/09/2026

vite më parë, ajo ka qenë Drejtuese Teknike në kompaninë farmaceutike ‘CFO Pharma’, në pronësi të sipërmarrësit Nadir Çauholli.

Emri i zonjës Bici gjendet edhe në një raport problematik, të hartuar në fillim të vitit 2026 nga ekspertët e Fondit të Kujdesit Shëndetësor, pas verifikimeve të kryera në aktivitetin e subjektit ‘CFO Pharma’ dhe kompani të tjera ‘satelite’ të saj.

Lexo edhe:

[I atyre..., singërisht, Besforti i Ramës!](#)

[Kreu i FSDKSH Ilir Topi mashtroi me formularin e dekriminalizimit dhe pasurinë/ Afera me depot farmaceutike](#)



Në foto: Rexhina Bici, aktualisht zv.drejtuese e Operatorit të Shërbimeve të Integruara Shëndetësore

Në një dokument të siguruar ekskluzivisht nga ‘**Boldnews.al**’, grupi i verifikimit ngriti dyshime për një skemë faturash fiktive, me qëllim rimbursimin e paligjshëm për llogari të ‘CFO Pharma’.

Ndër personat e dyshuar si përgjegjës për shkeljet me medikamentet e ndryshme, Grupi i Punës rendiste edhe Rexhina Bicin.

‘Në total, për ‘CFO Pharma Tiranë’, për barin Entresto 50 mg Kod LBR 698/92 dhe **Entresto 100 mg janë 6900 tableta sasi fiktive pas verifikimeve me vlerën 1,634,955 lekë**’, thuhet në një pasazh të raportit.

Më tej, Grupi i Punës shkruan: ‘Me daljet fiktive që subjekti CFO Pharma Tiranë’ me NIPT K22305002U ka bërë në sistemin e-depo, diferencat në plus të pajustificuara rezultojnë në total në shumën 1,634,955 lekë , bazuar ne kontratën Shpërndarës Farmaceutik... dhe mban përgjegjësi Administratori, Z.Frigul Milla. si dhe Drejtuese teknike, **Znj. Rexhina Bici**’.

13

Rr. ‘Samir Frashëri’, nr. 8, Tiranë. Tel: +3554223815. E-mail: info@fsdks.gov.al. Web: www.fsdks.gov.al 3 / 47

II. Për CFO Pharma Tiranë” me NIPT K22305002U rezultojnë diferencat janë si më poshtë;

- Në total për ‘CFO Pharma Tiranë’ me NIPT K22305002U për barin Entresto 50 mg Kod LBR 698/92 dhe Entresto 100 mg Kod LBR 699/92 janë 6900 tableta sasi fiktive pas verifikimeve me vlerën **1,634,955 (6900 x 236.95) lekë**.

Sanksionet:

- 1) - Me daljet fiktive që subjekti CFO Pharma Tiranë” me NIPT K22305002U ka bërë në sistemin e-depo, diferencat në plus të pajustificuara rezultojnë në total në shumën **1,634,955 lekë** , bazuar ne kontratën Shpërndarës Farmaceutik /2024 Neni 12 ‘Gjoba’, pika si pika 1 qe shprehen: ‘Kur nga kontrolli me inventarizim i barnave të rimbursueshme tek Shpërndarësi/Importuesi rezultojnë diferenca në plus të pajustificuara (gjendja fizike është më e madhe se gjendja kontabel), Shpërndarësi/Importuesi paguan gjobë në vlerë të barabartë me dyfishin e tepriçës së konstatuar” dhe mban përgjegjësi Administratori Znj.Frigul Milla. si dhe Drejtueses teknike **Znj. Rexhina Bici** përkatës. Gjoba në vlerën e ndalimit **3,269,910 lekë**.

Në foto: Pjesë nga raporti i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor

Në një tjetër pjesë të raportit të kontrollit, të miratuar në fillim të janarit 2026, thuhet: Në total për ‘CFO Pharma Tiranë’ , për barin **Insuline Glargine solution 100 Nj./ml**, sasi fiktive në vlerën 2,182,352, për barin **Insuline Detemir solution 100 Nj./ ml** , sasi fiktive pas verifikimeve me vlerën 2,337,995 lekë, për barin **Vildagliptin+Metformine 50mg ± 850mg**, sasi fiktive në vlerën 132,517 lekë dhe, për barin **Paliperidone 6mg prlg.tab**, sasi fiktive pas verifikimeve me vlerën 247,891 lekë.

Në foto: Pjesë nga gjetjet e Grupit të Punës, ku përmendet edhe emri i znj. Rexhina Bici

Pas këtyre konstatimeve, Grupi i Punës i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor thotë se “mban përgjegjësi Administratori Znj.Frigul Milla. si dhe Drejtuese teknike Znj. Rexhina Bici”.

LEXO EDHE:

Etiketa: CFO Pharma Fondi i Sigurimeve Ilir Topi rekhina bici shkarkim

Lajme të lidhura



I atyre..., sinqerisht, Besforti i Ramës!

13:36 : 11/09/2026



Kreu i FSDKSH Ilir Topi mashtron me formularin e dekriminalizimit dhe pasurinë/ Afera me depot farmaceutike

15:17 : 03/09/2026



Raporti/ Zbulohet roli i mjekëve në skemën e vjedhjes mln euro nga “CFO Pharma”, prokuroria hesht

08:40 : 27/07/2026



Nga hetimet për “CFO Pharma” te konflikti në rrugë, telashe të reja për Nadir Çaushollin, zbardhet kallëzimi i biznesmenit

18:35 : 06/07/2026



Policia procedon Nadir Çaushollin pas sherrit në ish-Bllok, ja për çfarë akuzohet

18:02 : 06/07/2026



Rimbursimi fiktiv i ilaçeve/ 400 farmaci “përfutuese” të Nadir Çaushollit, në krye “BioPlus” e Gazmend Aliaj

09:22 : 03/07/2026

BOLD NEWS

REETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.